



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për “Shqipërinë 2030” në Bashkimin Europian”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.7.2024, ora 09: 30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.7.2024.
2. Informim për zbatimin e vendimeve të mbledhjes së datës 10.7.2024.
3. Prezantimi dhe miratimi i konceptit dhe strukturës orientuese të dokumentit analitik (Analiza) që do të përgatitet nga grupi i ekspertëve, metodologjia e procesit dhe burimet e të dhënave dhe dokumenteve që do të shfrytëzohen për këtë qëllim.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Erion Braçe, Milva Ekonomi, Klotilda Bushka, Etilda Gjonaj, Evis Kushi, Toni Gogu dhe Eduard Shalsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Dhurata Tyli (Çupi), Flutura Açka dhe Sorina Koti.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Mund të fillojmë mbledhjen e komisionit, meqenëse kuorumi është i plotë.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.7.2024. Procesverbali ju është dërguar në rrugë elektronike.

Ka ndonjëri nga kolegët ndonjë koment? Dakord.

Sot kemi një vendimmarrje të rëndësishme në këtë mbledhje të komisionit të posaçëm parlamentar. Rezoluta dhe vendimi i Kuvendit e kanë përcaktuar qartë qëllimin dhe objektin e punës sonë, që lidhen me nevojën për të bërë një analizë nëpërmjet një dokumenti analitik.

Së dyti, për të hartuar një plan kombëtar veprimi në këto tri shtylla ku fokusohet komisioni.

Së treti, në lidhje me propozimet për masat ligjore dhe ndryshimet institucionale të mundshme.

Vendimmarrja e sotme lidhet pikërisht me dokumentin analitik. Gjatë kësaj periudhe njëmuajore, që nga ngritja e Komisionit të Posaçëm Parlamentar ne kemi punuar fort, së bashku me stafin e Kuvendit, pjesë e sekretariatit teknik, për të përgatitur gjithë procesin me masat e nevojshme organizative. Sot jemi duke hedhur hapin e parë të rëndësishëm, fillimin e fazës së parë të objektit të punës sonë, përgatitjen e analizës.

Për ta orientuar sa më drejtë dhe për ta fokusuar në çështjet kyçe të këtij dokumenti hartimin e kësaj analize, është përgatitur një koncept-ide me strukturën, lëndën orientuese, lidhur me përmbajtjen që do të duhej të kishte ky dokument analitik sipas këndvështrimit tonë. Sigurisht, po e them që në fillim, se ky është një draft pune, ose më saktë një projekt orientues, pasi në vijim dokumenti do të zhvillohet nga grupi i ekspertëve, me tre nëngrupet përkatëse, sipas tri shtyllave, dhe janë ata ekspertët e nivelit të lartë, që do të zgjidhen mbi bazën e propozimeve të ardhura nga bota akademike, shoqëria civile, grupet e interesit, institucionet e pavarura e të tjera, të cilët përmes një procesi shumë të thelluar analize do t'i japin formën dhe përmbajtjen e duhur këtij dokumenti analitik.

Procesi për hartimin e këtij dokumenti, ashtu si gjithë procesi për zhvillimin e kësaj reforme, do të udhëhiqet nga katër parime të rëndësishme.

Parimi themelor është gjithëpërfshirja, mbi të cilin do të ndërtohet ky proces. Me këtë nuk nënkuptojmë thjesht dhe vetëm pjesëmarrjen e të gjitha grupeve politike parlamentare, siç është miratuar tashmë nga Kuvendi, por një qasje shumë më të gjerë, me përfshirjen në këtë proces të të gjithë faktorëve e grupeve sociale të interesuara për të dhënë kontribut, përfshirë

këtu shoqërinë civile, botën akademike, komunitetin e biznesit, institucionet e pavarura, agjencitë ligjzbatuese, institucione të ndryshme të shtetit, që lidhen me këto tri fusha, si dhe profesionistë të interesuar, veçanërisht qytetarët, për të kontribuar në këtë proces.

Parimi i dytë i rëndësishëm, nga i cili do të udhëhiqet i gjithë procesi në tërësi, por edhe vetë faza e parë e hartimit të analizës, do të jetë transparenca. Ne synojmë që gjithë ky proces të jetë sa më i hapur, sa më transparent për grupet e interesuara, profesionistët, por dhe vetë qytetarët, nëpërmjet njohjes në kohë reale të produkteve që do të prodhojë komisioni, në mënyrë të veçantë grupet e ekspertëve, me organizimin e tryezave publike, me faqen *online* të komisionit, që, siç e kemi thënë edhe në mbledhjen e mëparshme, do të jetë një faqe informative, por dhe me një funksion interaktiv, për një komunikim intensiv me grupet e interesuara, profesionistët, qytetarët, të rinjtë e të rejtat, e veçanërisht studentët.

Parimi i tretë i rëndësishëm, që do të duhet ta përshkojë këtë proces, në mënyrë të veçantë këtë fazë të parë, është profesionalizmi, si një tjetër tipar i rëndësishëm. Kjo do të mundësohet nga fakti se pjesë e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë do të jenë kapacitetet më të mira që kemi aktualisht në këto fusha, ekspertë dhe profesionistë të njohur, me kontribute aktive në këto tri fusha, si mirëqeverisja, çështjet e antikorrupsionit, sundimi i ligjit, nga shoqëria civile, universitetet e vendit, pedagogë të njohur nga Fakultetet e Drejtësisë dhe Ekonomisë, të universiteteve publike e jopublike, komuniteti i biznesit, institucionet e pavarura dhe agjencitë ligjzbatuese.

Tashmë ky proces është duke u finalizuar. Kanë ardhur pothuajse të gjitha propozimet e nevojshme nga këto fusha që përmenda më sipër, dhe shumë shpejt, javën e ardhshme do të miratojmë në këtë komision përbërjen dhe organizimin e grupit të ekspertëve e të sekretariatit teknik në mënyrë definitive.

Natyrisht, një tjetër parim i rëndësishëm, që do të duhet ta përshkojë këtë proces është fakti se i gjithë procesi në vetvete dhe produktet e dala prej tij të jenë në pajtim, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare në këto fusha. Kjo do të arrihet duke u mbështetur fort në vlerësimet dhe gjetjet e prezantuara nga raportet, në mënyrë të veçantë nga raportet e Bashkimit Europian, raportet e vitit të kaluar dhe të këtij viti, asistencë e misioneve ndërkombëtare në Shqipëri, organizatat ndërkombëtare jashtë shtetit, por që mbulojnë këto fusha të rëndësishme, kontributet që do të sjellin organizatat ndërkombëtare dhe ekspertë të ndryshëm që do të organizohen si konsulentë të jashtëm, një pjesë e të cilëve kanë shprehur tashmë interes për t'iu bashkëngjitur këtij procesi.

Gjithashtu, sot do të duhet të përcaktojmë edhe metodologjinë. Në vija të përgjithshme, dua të them se sot do të prezantojmë me kolegët një koncept-ide për të tria shtyllat, por nga

pikëpamja metodologjike ky dokument do të punohet nga ekspertët, nga tre nëngrupet, të mbështetura nga Sekretariati Teknik. Pra, të organizuar në tre nëngrupe, sipas tri shtyllave: mirëqeverisjes, antikorrupsionit, sundimit të ligjit.

Bazuar në këtë dokument orientues, ekspertët do të fillojnë punën për hartimin e dokumentit analitik, me nëngrupet e tyre, dhe produktet e punës do t'ia nënshtrojnë debatit nëpër tryezat e ndryshme që do të organizohen, si dhe me konsultim publik përmes faqes sonë *online*.

Burimet e të dhënave e të dokumenteve që do të shfrytëzohen në lidhje me këtë proces do të jenë: së pari, baza e të dhënave që kanë vetë institucionet shqiptare dhe ato ndërkombëtare, që tashmë janë të njohura publikisht; dokumentet dhe aktet e ndryshme, të prodhuara gjatë viteve të fundit nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare e lokale, kryesisht raportet e Bashkimit Europian; udhërrëfyesit e miratuar tashmë nga qeveria, por njëkohësisht edhe raportet e organizatave të shoqërisë civile, një pjesë e të cilave tashmë janë vënë në dispozicion të komisionit.

Pra, pak a shumë këto janë parimet, metodologjia dhe burimet mbi të cilat do të mbështetet hartimi i kësaj analize të rëndësishme.

Tani është momenti t'ua kalojmë fjalën kolegëve, për të bërë një prezantim të përmbledhur, sipas tri shtyllave. Draftet janë goxha të gjera, por unë besoj se kolegët do të bëjnë një prezantim të përmbledhur të pikave kyçe, të momenteve kyçe të secilit prej tyre.

Le të fillojmë me shtyllën e parë, atë të mirëqeverisjes.

Besoj se zonja Ekonomi do të bëjë një prezantim.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë, zoti Xhafaj!

Në fakt, në shtyllën e parë, në atë të mirëqeverisjes, kemi punuar si një skuadër e vogël. Unë, Evisi dhe Eduardi kemi qenë bashkë në lidhje me hartimin e saj. Nuk ka rëndësi radha, sepse cili nga ne ka bërë më të mirën e vet, duke i lexuar të gjitha dokumentet.

Ne kishim parasysh një fakt, që ky proces do të ishte procesi i “Shqipërisë 2030” dhe procesi i integritimit në Bashkimin Europian, gjë, që edhe vetë titulli i punës së këtij komisioni e synon. Prandaj, kur u mbështetëm në dokumente për të hartuar shtyllën e parë, patëm parasysh kuadrin e brendshëm ligjor, por edhe atë ndërkombëtar, në të cilin Shqipëria ka aderuar, patëm parasysh angazhimet që ka marrë qeveria shqiptare në shumë organizma ndërkombëtar, lexuam me shumë kujdes progres-raportin e BE-së, raportin e *Screening*, sidomos kapitujt e parë, ose *clusterin* e parë, që ne e quajmë “Themelorët”. Lexuam raportet e ndryshme, të prodhuara për

Shqipërinë, si raportin e GRECO-s, të DASH-it, të SIGMA-s, të OGP-së, raportet e organizatave lokale, që kanë qenë bashkëpunues me ne dhe i kanë dorëzuar në Kuvend.

Gjithashtu, patëm shumë kujdes edhe në leximin e udhërrëfyesit, sidomos ato në reformën e administratës publike, si dhe udhërrëfyesin e sundimit të ligjit.

Ndërkohë që lexonim këto dokumente, ajo që na erdhi në mendje ishte një punë e ndarë, si të thuash, me tri gjetje kryesore. Gjetja e parë ishte të shikonim se çfarë konkluzionesh për arritje nxirrin në pah këto dokumente. Gjetja e dytë ishte të shikonim se çfarë mangësish në konkluzione kishin këto dokumente. Gjetja e tretë ishte të shikonim mundësinë se si këto mospërputhje – që në fakt nuk janë mospërputhje, por po i quajmë kështu për arsye diskutimi – midis arritjeve dhe objektivave për të arritur, duhej të adresoheshin në dokumentin që ne prodhuam.

Kësisoj, kur filluam të hartonim strukturën e kapitullit të parë, që është mirëqeverisja, ne patëm në vëmendje faktin se mirëqeverisja duhet të hartohet mbi bazën e pesë shtyllave kryesore. E para është transparenca në reformën e administratës publike; e dyta është efektshmëria dhe integriteti i administratës publike; e treta llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor; e katërta ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara për qytetarët; e pesta, efektiviteti dhe transparenca në menaxhimin e financave publike.

Unë do të përpiqem të paraqes në mënyrë shumë të përmblodhur disa nga orientimet për këto shtylla, që ne i kemi vënë te kapitulli i mirëqeverisjes. Kur flasim për transparencë në reformën e administratës publike, një nga gjërat që na është lënë vazhdimisht në vëmendje, ndërkohë që po punohet në Kuvend, është të shikojmë se çfarë efekti postlegjislativ prodhon ligji për qytetarët. Në fakt, për të kuptuar këtë, kemi nevojë për gjithëpërfshirje. Kjo nuk mund të jetë një detyrë që mund ta bëjë një komision këtu në Kuvend, apo që mund ta bëjnë Shërbimet e Kuvendit, por është e nevojshme edhe të merren opinione nga shoqëria civile e nga grupet e ekspertëve. Prandaj, duhet fokusim mbi këtë çështje, që të shikojmë gjithë procesin postlegjislativ, i cili nga ana tjetër duhet të ketë edhe përfshirjen e popullatës, e, me popullatë kuptojmë shoqërinë civile dhe grupet e teknikëve, gjë që do të jetë shumë e rëndësishme.

Nga ana tjetër, ajo që kemi vënë re gjatë leximit të dokumenteve, është fakti se Shqipëria ka prodhuar strategji, çdonjëra prej të cilave ka marrë vlerësim pozitiv nga grupi i ekspertëve ndërkombëtarë, që është përgjegjës për atë strategji, por tashmë ka ardhur koha që këto strategji të jenë të mirëkoordinuar me njëra-tjetrën, si dhe të matet efektshmëria e zbatimit të tyre. Kjo është një nga gjërat që kemi pasur në vëmendje në këtë pjesë të parë të mirëqeverisjes.

Natyrisht, aty kemi vënë më shumë çështje, por unë besoj se dokumenti është shkruar dhe publikuar në faqen e Kuvendit, te Komisioni i Posaçëm, ndaj nuk po kaloj në analiza më të thelluara.

Kur flasim për efektshmërinë dhe integritetin e administratës publike, kemi parasysh diçka shumë të rëndësishme në kuadrin e integritetit evropian. Për ne është e rëndësishme të krijojmë një administratë publike, e cila të ketë aftësi të përvetësues gjithmonë të rejtat që vijnë edhe nga përafrimi e nga zbatimi përfundimtar i rregulloreve të *acquis*. Administrata publike duhet të jetë e pajisur me ca aftësi, që duhet të vijnë në rritje, që ajo të jetë e zonja të ndjekë pikërisht frymën e zbatimit të rregulloreve. Përveç kësaj, na duhet të krijojmë një klasë të meritokracisë, kjo në kuptimin e profesioneve, që në administratën publike do të jenë të lidhura me zbatimin e *acquis*. Për shembull, kur ne flasim për klasën e mbikëqyrjes së tregut, ne duhet të kemi të krijuar një administratë publike, e cila është e aftë të mbikëqyrë tregun. Ose duhet të kemi në administratën publike persona kyç, që kanë njohurinë e zakonshme për t' u dhënë përgjigje çështjeve që lidhen me integritetin e një rregulloreje të caktuar në kushtet e ekonomisë shqiptare apo në kushtet e zhvillimit social që ka vendi. Kësisoj, në këtë moment, për ne është shumë e rëndësishme të gjejmë disa mekanizma, ku meritokracia të çohet më tej dhe klasa e ekspertëve të formohet sipas kapitujve që kërkon *acquis*.

Kur flasim për llogaridhënien e institucioneve të pushtetit vendor dhe qendror, është shumë e rëndësishme të marrim në konsideratë disa nga shënimet që ka dhënë udhërrëfyesi. Për këtë marrje në konsideratë nuk mjafton vetëm veprimtaria që mund të ndërmerret pushteti ekzekutiv, por duhet të kemi parasysh edhe që ne si Kuvend duhet të punojmë për këtë.

Janë lënë disa rekomandime për krijimin e agjencive që mund ta bëjnë më funksional zbatimin e rekomandimeve të *acquis*, gjë që në fakt është një ndër gjërat e rëndësishme. Për shembull, një nga gjërat që duhet të kemi parasysh është edhe fakti që, nëse themi se duhet të zbatohet ndihmën shtetërore, për shembull, ndihma shtetërore ka nevojë për një agjenci të specializuar, siç janë në vendet e Bashkimit Evropian, që të ndjekë ndihmën shtetërore në kushtet e Republikës së Shqipërisë. Në këtë moment, nevojat për të kuptuar se çfarë agjencish janë jashtë funksionit tani, si dhe agjencitë që kanë nevojë të transformojnë rolin për të qenë përgjegjëse në lidhje me zbatimin e *acquis*, do të jetë një nga punët më të rëndësishme që duhet të kemi parasysh. Harta e kryerjes së detyrave në administratën publike do të jetë një hartë, e cila do të jetë gjithmonë e gjallë, sepse do të ndryshojë për të ndjekur rekomandimet e *Acquis*.

Nga ana tjetër, sot është fat i madh që kemi vënë pushtetin vendor në një fokus të ri, duke i dhënë mundësinë të kuptojë se zbatimi i rekomandimeve të *Acquis* nuk është vetëm detyrë qendrore, por është edhe një detyrë vendore. Kësisoj, në lidhje me shumë nga detyrat që

lidhen me pjesën e pushtetit vendor kemi filluar të veprojme që tani. Megjithatë, ka nevojë për një monitorim e një llogaridhënie të vazhdueshme nga ana e pushtetit vendor s ai takon zbatimin të këtyre rekomandimeve. Ne duhet të luftojmë fort për të gjetur disa nga instrumentet që e bëjnë të mundur një gjë të tillë, ama instrumente që janë të lehtë, jo që të sjellin një ngarkesë të shtuar mbi administratën e pushtetit vendor. Kësisoj, duhet shumë punë. Natyrisht, grupi i sekretariatit dhe grupi i ekspertëve duhet të mendojnë për procese inxhinierike të lehta e të mirëzbatueshme.

Kur vjen fjala për ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara ndaj qytetarëve, – gjë që e patëm shumë për zemër bashkë me Evisin dhe Eduardin, që të mendonim e të punonim në lidhje me këtë – duke u nisur nga fakti se këtu ka nevojë edhe për shumë çështje që kanë të bëjnë me edukimin dhe arsimimin e vazhdueshëm të brezit të ri në Shqipëri, unë mendoj t'ia lëmë Evisit paraqitjen e kësaj pike.

Evis Kushi – Faleminderit, Milva!

Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë desha të shtoja këtu diçka që lidhet me një nga komponentët më të rëndësishëm të mirëqeverisjes, e që është pikërisht digjitalizimi i shërbimeve.

Në fakt, deri tani kemi ndërmarrë shumë reforma rrënjësore, reforma strukturore në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve në të gjithë sektorët. Kemi investuar shumë në infrastrukturë, në burimet njerëzore, në rritjen e kapaciteteve, në trajnimin e administratës publike, por gjithashtu kemi përmirësuar legjislacionin. Sigurisht, qëllimi kryesor ka qenë lehtësimi i qytetarëve, lehtësimi i bizneseve, aksesit i barabartë për të gjithë, por ajo që është akoma më e rëndësishme, është ulja e korrupsionit.

Unë nuk do të zgjatem në lidhje me ato që kemi bërë, sepse e kemi pasur shpeshherë mundësinë t'i theksojmë për qytetarët, çka se qytetarët dhe bizneset i aksesojnë çdo ditë shërbimet e digjitalizuara. Unë do të përmend vetëm atë që ndoshta është kryereforma në sistemin e digjitalizimit të shërbimeve, që është platforma *e-Albania*, e cila përbën vërtetë një revolucion, sepse ka ndërthurur, ka integruar të gjithë regjistrat e shtetit shqiptar, në të gjithë sektorët.

Sigurisht, ambicia jonë është për shumë më tepër se kaq. Ambicia jonë është të shkojmë përpara, jo vetëm të përmirësojmë shërbimet, por edhe të shfrytëzojmë në maksimum potencialin e jashtëzakonshëm që ka inteligjenca artificiale. Këtë edhe për lehtësimin e procedurave për qytetarët dhe bizneset, po edhe për ta modernizuar shtetin shqiptar, për të ndihmuar personat me aftësi ndryshe, për të ndihmuar personat e moshës së tretë e kështu me radhë.

Pra, sfida jonë është të përmirësojmë shërbimet, por edhe t'i garantojmë ato. Kjo nuk është një sfidë që e ka vetëm Shqipëria, por në të vërtetë është një sfidë globale. Pra, në këtë sfidë Shqipëria nuk është e vetme, por duhet t'i integrojë përpjekjet e saj me rrjetet globale, me vendet e tjera, me zhvillimet në teknologji, me zhvillimet në inovacion, me kërkimet shkencore.

Prandaj, në vizionin 2030 duhet të mendojmë një strategji më të qartë, në lidhje me mënyrën se si do t'i çojmë përpara investimet në sistemin e digjitalizimit të shërbimeve, për të pasur më shumë ekonomikitet, për të pasur më shumë efektivitet, për të pasur më shumë garanci mbrojtjeje sa u takon sistemeve, për të pasur sisteme të sigurta; si do ta çojmë përpara kërkimin shkencor, si do ta çojmë përpara inovacionin, pra, për t'i drejtuar, për t'i orientuar në këto drejtime; si do t'i rrisim më tej kapacitetet e administratës publike e kështu me radhë.

Kësisoj, pikërisht për këtë vizion, ne tashmë e kemi të qartë se si do ta orientojmë punën në lidhje me këtë komponent në tri shtylla kryesore, që janë: digjitalizimi i shërbimeve publike, me në qendër qytetarin, rritja e performancës dhe ulja e korrupsionit. Së dyti *e-government*, e ndërtuar sipas standardeve europiane, siç e përmenda pak më parë, pra korniza europiane e ndërveprimit. Së treti, qëndrueshmëria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve.

Sfida është e vështirë, por ne kemi hedhur tashmë baza të shëndosha. Duke pasur të qartë edhe vizionin se ku do të shkojmë, duke mbledhur të gjitha forcat, duke qenë të gjithë bashkë në këtë drejtim, unë besoj se do të arrijmë të bëjmë më të mirën.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Kushi!

Milva Ekonomi – Kemi edhe një çështje të pestë, e cila ka të bëjë me efektivitetin dhe transparencën në menaxhimin e financave publike. Ne i kemi pasur shumë në konsideratë të gjitha rekomandimet që na kanë lënë raportet ndërkombëtare, sidomos për një situatë të shëndetshme financiare të ndërmarrjeve shtetërore dhe në situatën e pushtetit vendor. Për këtë arsye, kemi pasur në vëmendje dy gjëra: së pari të shohim në tabelë riskun që vjen nga përdorimi i fondeve të ndërmarrjeve shtetërore dhe nga institucionet e pushtetit vendor; së dyti të shikojmë se si mund të mitigojmë të gjitha risqet që vijnë nga përdorimi i financave në administratën qendrore.

Për këtë arsye, ne kemi bërë vazhdimisht diskutime këtu në Kuvend, siç kemi bërë diskutime edhe për gjithë procesin e vëzhgimit postlegjislativ. Kemi bërë diskutime edhe për të pasur një komision, që është Komisioni i Kontrollit Financiar, që është i domosdoshëm për t'u ngritur, arsye për të cilën ka nevojë për një veprimtari shumë të përkorë sa i takon zbatimin

të ligjshmërisë financiare në Republikën e Shqipërisë, që duhet të përafrohet gjithnjë e më shumë me kërkesat europiane.

Nga ana tjetër, kemi parasysh edhe një fakt të rëndësishëm, faktin që në Shqipëri punojmë me listën e projekteve prioritare kombëtare, e cila ka zënë vend këtë vit për herë të parë. Përditësimi i listës së projekteve prioritare kombëtare dhe ndjekja e të gjitha investimeve publike në pikëpamjen financiare në Shqipëri është shumë e rëndësishme. Megjithatë, është e rëndësishme të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, arsye për të cilën kërkohen instrumente të rinj ligjorë, por kërkohen edhe zbatime më konkrete në administratën qendrore.

Edhe sa i takon kësaj, ne kemi menduar se duhet të zërë një vëmendje të veçantë. Në këtë periudhë që po lëmë pas Shqipëria i ka bërë të gjitha përpjekjet maksimale për të dalë nga lista gri e pastrimit të parave, për të pasur një performancë financiare të pëlqyeshme, duke marrë vazhdimisht vlerësime sa i takon qëndrueshmërisë financiare edhe nga ana e Standard & Poor's. Kësisoj, ne jemi munduar që këtë shtyllë të mirëqeverisjes ta ndajmë në katër çështje kryesore, të cilat lidhen edhe me hartimin e politikave të reja, që lidhen edhe me analizimin e vazhdueshëm të gjetjeve të risqeve fiskale, duke pasur vazhdimisht në vëmendje faktin se projektet kombëtare prioritare janë projekte që nuk ndryshojnë shpejt, por janë projekte që, mbasi përmbyllen kanë një gjurmë të kjo listë dhe kërkojnë revizionim të saj.

Natyrisht, në hartimin e këtyre çështjeve të kapitujve, ne kemi pasur në konsideratë edhe aftësinë e fituar deri tani në administratën tonë qendrore, sepse dimë se sot në Shqipëri, në administratën tonë qendrore ka ekspertë të aftë, të cilët mund ta çojnë më tej gjithë këtë vizion që ka shoqëria shqiptare – nuk them vetëm qeveria, por shoqëria shqiptare – për të arritur objektivat e mirëqeverisjes në agjendën Shqipëria 2030.

Unë jam besimplotë se këta ekspertë që punojnë në administratën publike kanë angazhimin për të ecur përpara dhe kryer si duhet detyrat, edhe në bashkërendim me gjetjet që kanë bërë institucionet ose agjencitë e tipit *think tank*, që veprojnë në sferën e shoqërisë civile.

Faleminderit shumë!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje apo ndonjë koment në lidhje me prezantimin?

Janë dy-tri gjëra këtu, por nuk besoj se janë shumë të rëndësishme, por ndoshta kur ta rishikojmë draftin mund t'i diskutojmë, para se të çojmë versionin final për ekspertët.

Për shembull, është një gjë që vjen ndërmend, Milva. Ne themi: efektiviteti dhe transparenca në menaxhimin e financave publike, por është shumë i rëndësishëm kontrolli i menaxhimit. Efektiviteti, transparenca dhe kontrolli i menaxhimit. Se e gjeta edhe te pjesa e raporteve të BE-së këtë.

Në rregull! Mirë!

Milva Ekonomi – Patjetër që ne do t'i shikojmë në mënyrë shumë më të detajuar të gjitha, sepse në fakt këto ishin reflektime përmbledhëse.

Fatmir Xhafaj – Në rregull!

Milva Ekonomi – Ndërkohë mund ta kalojmë edhe me një sy të dytë, patjetër!

Fatmir Xhafaj – Qartë! Keni të drejtë!

Në rregull! Faleminderit!

Kalojmë te shtylla e dytë: antikorrupsioni.

Zoti Braçe! Zonja Gjonaj!

Në rregull!

Etilda Gjonaj – Faleminderit, kryetar!

Shtylla e dytë ku është fokusuar veprimtaria e këtij komisioni është lufta kundër korrupsionit. Kjo është një fushë shumë e rëndësishme, besoj edhe më sensitivja, pasi pavarësisht masave dhe përpjekjeve të jashtëzakonshme që janë ndërmarrë nga qeveria dhe nga kjo mazhorancë për të luftuar korrupsionin, jemi të vetëdijshëm, por njëkohësisht kemi edhe pjekurinë politike për të pranuar faktin se ka ende shumë për të bërë. Po ashtu kemi vullnetin dhe angazhimin për të adresuar dhe luftuar korrupsionin, me qëllimin për të çliruar njëherë e mirë qytetarët, pore dhe gjithë shoqërinë nga abuzimet dhe veprimet korruptive.

Analiza që kemi menduar dhe planifikuar se do të duhet të zhvillohet nëpërmjet këtij dokumenti analitik, ashtu siç edhe u tha, do të ndjekë një metodologji tashmë të unifikuar me të gjitha shtyllat që janë objekte adresimi të këtij komisioni. Nga një skedim paraprak që kemi kryer, kuadri dhe burimet kryesore udhërrëfyese për këtë shtyllë, padyshim që në radhë të parë do të jenë kuadri ligjor e kushtetues në fuqi, si i brendshmi ashtu edhe ai ndërkombëtar, rekomandimet e gjetjet kryesore të progresraportit dhe të raportit *Screening* për grup-kapitujt e parë, Themeloret, si kritere e kushte kryesore, të cilat në fakt Shqipëria do të duhet t'i përmbushë edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian. Këto do të jenë dokumentet kryesore, që do të udhëheqin gjithë procesin e analizës, sipas asaj çfarë ne kemi menduar, por që do t'ia sugjeronim edhe grupit të ekspertëve. Gjithashtu, pjesë e këtij konteksti është edhe raporti i Bashkimit Evropian për shtetin e së drejtës, i cili pritet të publikohet së shpejti.

Nga ana tjetër, janë dy udhërrëfyesisht e miratuar në dhjetor të vitit 2023 nga qeveria shqiptare: Shteti i së drejtës dhe Reforma në administratën publike. Po ashtu, është edhe udhërrëfyesi i tretë, që pritet të miratohet së shpejti, i cili ka të bëjë me funksionet e institucioneve të pavarura. Gjithashtu do të jenë burime kryesore dokumentet strategjike e ndërsektoriale, të miratuar nga qeveria në luftën kundër korrupsionit, angazhimet e qeverisë

shqiptare në organizmat ndërkombëtare, e po ashtu raporte të ndryshme të organizatave politike e të organizatave ndërkombëtare, ku Shqipëria është anëtare apo ka një detyrim për të përmbushur rekomandimet sipas standardeve të vendosura.

Nga ana tjetër, raportet GRECO, MONEYVAL, Departamenti Amerikan i Shtetit, që së fundmi prezantoi raportin për Shqipërinë, OGP, *Transparency International*, OECD, shumë raporte e analiza të shoqërisë civile dhe organizatave të tjera të biznesit.

Metodologjia e kësaj analize të thelluar të problematikave që lidhen me korrupsionin do të fokusohet në përshkrimin e kontekstit aktual e të vlerësimeve, arritjet dhe hapat pozitivë, gjetjet, problematikat dhe sfidat që evidentohen në këtë fushë, si dhe drejtimit e nevojat e ndërhyrjeve me masa legjislative apo institucionale, duke marrë në konsideratë edhe eksperiencat më të mira të vendeve europiane, pa dyshim edhe *acquis communautaire*, që do të jetë një detyrim edhe për Shqipërinë gjatë këtij procesi të negociatave.

Bashkë me kolegun Braçe kemi qenë përgjegjës për të zhvilluar elementët, komponentët e kësaj shtylle. Po ashtu edhe me stafin e Kuvendit, të atashuar pranë grupit tonë, ekspertë shumë të mirë me të cilët jemi konsultuar gjatë kësaj periudhe, kemi evidentuar e sugjeruar që grupi i ekspertëve ta zhvillojë analizën për shtyllën kundër korrupsionit në pesë komponentë.

Komponenti i parë lidhet me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit politik. Në këtë komponent do të adresohen dy nënkomponentë kryesorë apo dy çështje kryesore madhore.

Nënkomponenti i parë fokusohet te parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit për zyrtarë të lartë politikë, të zgjedhurit, por dhe vetë partitë politike, me fokus të veçantë adresimin e kontrollit dhe pastërtinë e figurës së të zgjedhurve dhe zyrtarëve të lartë politikë. Këtu përfshihet konflikti i interesave të zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve, mekanizmat për procesin e pastërtisë së figurës për të zgjedhurit dhe zyrtarët e lartë, financimi e transparenca e financave në fushatat e partive politike, sponsorizimet e donacionet për partitë politike, si dhe parandalimi e lufta ndaj korrupsionit transnacional të zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve.

Nënkomponenti i dytë adreson nevojat për një ligjëbërje të pastër nga interesat individuale, duke u fokusuar te mekanizmat ligjorë e institucionalë, për të parandaluar dhe kontrolluar hapësirat për korrupsion në ligj, si dhe rregullimin e çështjeve të lobimit nga zyrtarët e lartë dhe të zgjedhurit.

Komponenti i dytë fokusohet te parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në sektorët me risk më të lartë korrupsioni, duke përfshirë qeverisjen qendrore dhe qeverisjen vendore. Gjithashtu, ky komponent është i fokusuar në tre nënkomponentë.

Nënkomponenti i parë ka të bëjë me situatën aktuale, gjetjet për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në administratën publike qendrore dhe sektorët e qeverisjes qendrore me risk të lartë ndaj korrupsionit, duke u fokusuar në mënyrë të posaçme në ndalimin e konfliktit të interesit për nivelin drejtues në administratën qendrore, mekanizmat për kontrollin e figurës së nivelit drejtues në administratë, integritetin dhe kohëzgjatjen në pozicione drejtuese, në analizën e sektorëve me risk më të lartë korrupsioni, tashmë të vendosur në fokus edhe nga Bashkimi Europian, si tatimet, doganat, pronat, arsimi e shëndetësia, por njëkohësisht edhe fokusi në prokurimet publike, koncesionet, investimet strategjike, lejet, licencat e të tjera.

Nënkomponenti i dytë lidhet me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në administratën publike të pushtetit vendor. Siç e përmenda edhe më sipër, ky komponent do të adresojë si qeverisjen qendrore, ashtu edhe qeverisjen vendore, po njëkohësisht edhe sektorët e qeverisjes vendore me risk më të lartë korrupsioni, duke u fokusuar në ndalimin e konfliktit të interesit për nivelin drejtues në pushtetin vendor, kontrollin e figurës, integritetin dhe kohëzgjatjen në detyrë të nivelit drejtues, planet e integritetit për organet vendore e mekanizmat e tyre kontrollues, ashtu si në fushat me risk të lartë korrupsioni, taksa, shërbime, menaxhime të pronave dhe aseteve publike, lejeve, licencave e të tjera.

Nënkomponenti i tretë lidhet me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, në funksionimin e tregut të lirë, konkurrencës në sektorin privat, e njëkohësisht duke parë institucionet rregullatore, mbikëqyrëse e menaxhuese, duke u fokusuar në funksionimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e tregjeve, duke përfshirë atë të bankareve, sigurimeve, kapi taleve, por edhe të konkurrencës së ndershme. Gjithashtu, është fokusuar te inspektimet te subjektet tregtare, që kryhen nga sektorët e drejtoritë përkatëse, si dhe te funksionimi i masave për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit te këta sektorë që kryejnë inspektimin. Në fokus do të ketë edhe institucionet mbikëqyrëse dhe rregullatore të tregut, si AKU, AKEP, AMF e të tjerë, që do të evidentohen edhe nga grupi i ekspertëve. Gjithashtu, risi është edhe fokusi te parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në sektorin privat, tashmë e zhvilluar në të gjitha vendet e Bashkimit Europian, e nga ana tjetër përfshirë si një ndër elementët që do të duhet të adresohet në luftën kundër korrupsionit.

Komponenti i tretë i dedikohet funksionimit dhe eficiencës së institucioneve që luftojnë korrupsionin, konfliktit të interesit dhe abuzimit me financat publike. Këtu keni sugjeruar dy nënkomponentë.

Nënkomponenti i parë fokusohet në funksionimin institucional e në efektshmërinë e institucioneve me përgjegjësi në luftën kundër korrupsionit dhe monitorimit të efektshmërisë së fondeve publike, duke përfshirë qeverisjen qendrore, qeverisjen vendore, si dhe institucionet

e pavarura. Në mënyrë të posaçme kemi përfshirë si elementë për t'u fokusuar: kontrollin e brendshëm financiar publik, përfshirë mbikëqyrjen e menaxhimit të fondeve publike apo procedurat që ndiqen nga institucionet qendrore vendore, si inspektimi financiar i Ministrisë së Financave, mekanizmat e brendshme audituese e kontrolluese, mekanizmat audituese për financimet nga programet e huaja dhe ato të BE-së, si programet IPA e të tjerë, e po ashtu kontrollin dhe mbikëqyrjen e menaxhimit të fondeve publike dhe konfliktit të interesit nga institucionet e pavarura, të përcaktuara nga Kushtetuta e ligji.

Nënkomponenti i dytë fokusohet në mbikëqyrjen e zbatimit të kuadrit antikorrupsion dhe hetimit administrativ antikorrupsion. Fokusi do të jetë te Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, drejtoritë antikorrupsion në Tatime, Dogana e në çdo sektor që ka një drejtori apo sektor përkatës, si edhe në situatën aktuale të hetimit dhe gjyqimit të rasteve të korrupsionit.

Komponenti i katërt lidhet me parandalimin e flukseve të paligjshme financiare dhe pastrimit të parave, duke e konsideruar si një burim e si një mekanizëm që do të duhet të adresohet në luftën kundër korrupsionit.

Nënkomponenti i parë do të fokusohet në parandalimin e flukseve të paligjshme financiare me ndërhyrje keqdashëse të vendeve të tjera në ekonomi e në infrastrukturën kritike, po edhe në parandalimin e pjesëmarrjes në procedura prokurimesh publike, investimesh strategjike nga subjekte me ndërhyrje keqdashëse nga vendet e tjera.

Nënkomponenti i dytë fokusohet te masat ligjore e institucionale për efektshmërinë e parandalimit të pastrimit të parave. Në mënyrë të posaçme theksi do të jetë te masat e zbatimit në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe çfarë ka nevojë më tej, pavarësisht se Shqipëria ka marrë një vendim pozitiv për daljen nga lista gri, zbatimin e sistemit të regjistrimit të pronarëve përfitues dhe masave të tjera që do të duhet të merren në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave. Nga ana tjetër, një aspekt i rëndësishëm, që sot e gjen në çdo strategji e në çdo masë që shtetet demokratike kanë marrë, ka të bëjë me parandalimin e pastrimit të parave në nivel transnacional.

Ashtu siç jemi të vetëdijshëm se lufta ndaj korrupsionit nuk fitohet nëse nuk përfshihen të gjithë aktorët dhe vetë shoqëria, kemi sugjeruar që komponenti i pestë të fokusohet te ndërtimi i një shoqërie me integritet, duke përfshirë dy nënkomponentë:

Nënkomponenti i parë lidhet me nxitjen e denoncimeve të rasteve të korrupsionit dhe përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile, të qytetarëve, grupeve të interesit, për monitorimin e menaxhimit të financave publike nga aktorët, por nga ana tjetër edhe mbrojtjen e denoncuesve të korrupsionit.

Nënkomponenti i dytë do të fokusohet në ndërgjegjësimin e shoqërisë, veçanërisht të të rinjve, në lidhje me ndërtimin e një shoqërie me integritet, duke u fokusuar edhe te zbatimi i programeve apo kurrikulave arsimore për nxënësit dhe studentët lidhur me integritetin dhe luftën kundër korrupsionit.

Këto janë pesë fushat kryesore, që bashkë me kolegun Braçe dhe gjithë ekipin do t'ia sugjeronim grupit të ekspertëve, që analiza të fokusohet në këto komponentë, shoqëruar edhe me rekomandimet përkatëse.

Unë kaq kisha!

Besoj se kolegu Braçe do të ketë diçka për të shtuar.

Faleminderit!

Erion Braçe – Siç tha edhe zonja Gjonaj, ne kemi punuar bashkë dhe patjetër që jemi munduar të reflektojmë çdo vlerësim, çdo analizë të bërë deri më sot në nivel kombëtar e ndërkombëtar, përfshirë edhe raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit, që u bë prezent dje, nga mesdita e tutje.

Afërmendsh, ne njohim çdo arritje të bërë deri tani në fushën e luftës kundër korrupsionit, ashtu siç edhe të dhënat burimore të këtyre raporteve, por edhe analiza të tjera të bëra deri më sot e kanë njohur këtë fakt. Edhe raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit që u prezantua dje vlerësonte faktin që është bërë përparim i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit të vogël, kjo falë aplikimit të teknologjisë, qoftë për qytetarët, qoftë për bizneset.

Natyrisht, unë e gjej me vend edhe atë që thanë zonjat pak më parë, zonja Milva dhe zonja Evis, që ne duhet të vazhdojmë të thellohem në këtë pikë. Por ajo që theksohet thuajse në të gjitha raportet, edhe në raportin e djeshëm të Departamentit Amerikan të Shtetit, ka të bëjë me dobësinë e madhe që ne kemi në lidhje me atë që konsiderohet korrupsioni i madh.

Pikërisht për këtë arsye, por dhe për faktin se nga ky korrupsion impaktohet edhe demokracia, edhe ekonomia, e të ndërthurura bashkë, e gjithë shoqëria, ne jemi fokusuar në këto shtylla. Nuk kemi nisur, kot apo për shkak të hierarkisë vendimmarrëse, me korrupsionin politik. E kemi bërë këtë, sepse mendojmë se atje duhet adresuar problemi: te partitë politike dhe te trupat që krijohen nga zgjedhjet, trupat politike brenda partive, trupat politike që krijohen brenda institucioneve të rëndësishme kushtetuese të shtetit, siç janë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, qeveria, duke zbritur deri në nivelin administrativ.

Për ne është shumë e rëndësishme që këto trupa t'u nënshtrohen kontrollit të figurës. Deri tani ka qenë fakultative, në vullnetin e partive politike, ndërsa tani duam ta bëjmë të detyrueshëm kontrollin e figurës, sepse duam që këto trupa t'u ruhen fort qoftë kapjes në nivelin kombëtar, qoftë kapjes në nivelin ndërkombëtar. Ajo që është e ndërthurur me një komision

tjetër, ku unë dhe zonja Gjonaj jemi anëtarë, ka të bëjë pikërisht me këtë fakt: që të vihet se evidencë që ndërhyrjet e huaja, keqdashëse, si synim kryesor kanë kapjen e elitave politike.

Thënë këtë, i kemi kushtuar një vëmendje shumë të rëndësishme pikërisht këtij fakti: kontrollit të figurës, por edhe proceseve që burojnë nga këto trupa. Shembull është Kuvendi, i cili duhet të mbrojë pa diskutim procesin ligjberës nga klientelizmi, korrupsioni e kapja, ashtu sikundër edhe procesi i kontrollit parlamentar duhet të ruhet fort nga këto fenomene. Nga ana tjetër, pa më të voglin diskutim, ne kemi një problem shumë të madh sa i takon kënetëzimit të nivelit politik të drejtimit të administratës. Kjo do të thotë se kemi vendosje dhe qëndrim nëpër detyra politike në administratë, që shkojnë përtej afateve logjike, ose që përshtaten me afate që u shkojnë për shtat korrupsionit të zyrtarëve.

Çfarë kemi menduar në lidhje me këtë pikë? Ne duam të nxisim përkohshmërinë e drejtuesve politikë në gjithë nivelin politik të drejtimit të shtetit. Përkohshmëri. Nuk mundet që një drejtues të shkojë deri në 6, 7, 8, 9 vjet. Imagjinoni pak: ai drejtues është i pazgjedhur, nuk i nënshtrohet kontrollit dhe gjyqimit me votë, por thjesht një emërimi politik, që vjen nga një tjetër zyrtar politik. Pikërisht për këtë arsye, ne kërkojmë përkohshmëri të qenies së tyre në detyrë, në funksionin politik që mbajnë. E kur them "në funksionin politik" kam parasysh të përfshijmë gjithçka. Gjithçka. Edhe ata që merren me atë korrupsionin e vogël, që buron nga një pushtet politik, i cili shpesh kthehet në abuziv, edhe ata që merren me korrupsionin e madh.

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, impakti që jep korrupsioni mbi ekonominë ka dy drejtime kryesore. Njëri drejtim janë prokurimet publike, dhe ne zakonisht trupat prokurorese i kemi me burim të qartë nga funksione politike, e këtu duhet të ndodhë çlirimi total ose përkohshmëria e atyre që janë burimi i vendimmarrjes për prokurimet publike. Drejtimi tjetër është konkurrenca e munguar, thuhet atje. Për të mos vazhduar pastaj me klientelizmin, theksohet prapë atje. Vonesa, shtyrja në kohë për dhënie licencash, për dhënie udhë praktikash, ku zakonisht përfshihen edhe investitorë të huaj, që janë jetikë për ekonominë kombëtare të këtij vendi. Pikërisht për këtë arsye, ne kemi shtuar edhe dy elementë të tjerë shumë të rëndësishëm, që zonja Gjonaj i përmendi, por që unë dua t'i theksoj.

Së pari është kontrolli i figurës së këtyre zyrtarëve. Pra, në qoftë se deri tani kontrollin e figurës së zyrtarëve e kemi pasur deri në nivelin e deputetëve, të zgjedhurve, kryetarëve të bashkive, të zgjedhur edhe ata, kontrollin e figurës duam ta shtrijmë edhe në këtë aspekt.

Së dyti, ndalesa për secilin prej tyre, që në ato pika, në ato ndërthurje që deri tani kanë sjellë klientelizmin dhe konfliktin e interesave si elementë kyç të evidentuar në raste të dyshuara si korrupsion, në raste të hetuara si korrupsion, në raste edhe të gjykuara kohët e fundit po prapë si korrupsion. Çfarë dua të them? Dua të them që zyrtari politik që ka në dorë

vendimmarrje, patjetër që duhet të ketë ndalime para marrjes së detyrës dhe pas marrjes së detyrës. Kjo me qëllim që të mirat që ai zotëron përmes vendimmarrjes së tij, të mos derivojnë atje ku ka qenë aksioner, atje ku ka qenë drejtues, apo të mos derivojnë atje ku nesër do të jetë aksioner apo drejtues.

E fundit që dua të theksoj ka të bëjë me atë fenomen që konsiderohet shpesh si korruptimi i antikorrupsionit. Pra, është pika e katërt që theksoi zonja Gjonaj, pikë që lidhet drejtpërdrejt me institucionet që duhet të luftojnë korrupsionin. Një pjesë e rëndësishme e tyre duhet t'i nënshtrohet një reforme të thellë. Ka tridhjetë e pesë vjet që nuk ndryshojnë. Nuk ndryshojnë në strukturë, nuk ndryshojnë në funksione. Natyrisht, të bësh të njëjtën gjë tridhjetë e pesë vjet, pa ndryshuar asgjë, nuk mund të presësh rezultate të tjera. Për më keq akoma, që edhe nën vullnete politike, një pjesë e tyre janë korrumpuar. E më besoni: për një vend nuk ka gjë më të tmerrshme se korruptimi i instrumenteve të antikorrupsionit. Në qoftë se bien edhe ato, atëherë mund të themi dhe mund të pranojmë gjerësisht se jo vetëm nuk ka më betejë kundër korrupsionit, por më keq akoma, nuk mund të ketë as në të ardhmen betejë kundër korrupsionit. Kështu që, fokusi i vendosur në këtë pikë synon pikërisht këtë gjë: çlirimin e instrumenteve të korrupsionit dhe një imunitet që duhet t'u japim këtyre institucioneve, që të mbrohen edhe ato vetë nga korrupsioni.

E fundit që dua të them: ky nuk është më një problem thjesht e vetëm i një partie politike, i një mazhorance, i një opozite e kështu me radhë. Ky duhet të jetë problem shoqëror. Në qoftë se nuk ngrihet në nivelin e një problemi shoqëror, dhe nëse nuk bëhet palë në luftën kundër korrupsionit, do të jetë shumë e vështirë që thjesht organet e drejtësisë, thjesht një qeveri me segmentet e saj ekzekutive apo thjesht një parlament me funksionet e veta kontrollues e legjislative, të mund ta përballojnë këtë betejë. Kësisoj, duhet patjetër që edhe ne që jemi këtu, edhe këto instrumente që po miratojmë këtu për shtyrjen përpara të punës së këtij komisioni, duhet të bëhen pjesë e shoqërisë. Në momentin që bëhen pjesë e shoqërisë, atëherë mund të kemi krijuar një front, që i vihet përballë çdo fenomeni korruptiv, çdo individ apo grupi që kërkon të korruptojë procese të ndryshme ekonomike, legjislative e politike në funksion të përfitimeve të veta personale apo dhe të grupit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Faleminderit, zoti Braçe!

Ka ndokush gjë tjetër në lidhje me këtë? Apo të vazhdojmë?

Në rregull! Zonja Bushka apo zoti Gogu?

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Atëherë, te nëngrupi ynë “Sundimi i ligjit”, bashkë me zotin Gogu, me ndihmën edhe të sekretariatit të komisionit, kemi vlerësuar që në vijim të qëllimeve për të cilat ky komision punon, por edhe të atyre që janë të parashtruara qartë në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, sipas gjykimit do të do të duhet të bëjmë një rreshtim të atyre çështjeve që do të duhet të jenë pjesë e një analize. Meqë flasim për sundimin e ligjit, Komisioni i Venecias ka një dokument të plotë sa i takon indeksit të sundimit të ligjit. Në këtë këndvështrim, parë në planin e të gjitha angazhimeve që ka qeveria shqiptare dhe shteti shqiptar në organizmat ndërkombëtare, progresraportet e Bashkimit Europian, raporti i *Screening, cluster 1*, raportin më të fundit të BE-së, Shteti i së drejtës 2024, raportet e tjera ndërkombëtare, siç janë: GRECO, raportet e grupit të shteteve kundër korrupsionit, të Këshillit të Europës, raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit apo raporte të tjera ndërkombëtare të ngjashme me këto, që lidhen me çështje të sundimit të ligjit. Jo më pak të rëndësishme janë raportet e organizatave të shoqërisë civile, raportet vendëse të grupeve të interesit për të njëjtat çështje, masat kyçe të udhërrëfyesve, të cilat janë miratuar nga shteti shqiptar, nga qeveria, si shteti i së drejtës dhe reforma në administratën publike, udhërrëfyesi i funksionimit të institucioneve demokratike e të tjera.

Duke parë natyrën e punës së këtij komisioni, ne kemi vlerësuar që me burim gjetjet dhe hapat pozitivë në këtë fushë, si dhe me vlerësimet e bëra në raportet ndërkombëtare e problematikat që kanë dalë, ta ndajmë kërkesën për analizë për këtë komponent të sundimit të ligjit, në tre komponentë.

Së pari, do ta nisim nga Kuvendi, nga roli ynë. Është roli i Kuvendit në të gjitha këto aspekte të rëndësishme, të cilat ndihmojnë mirëqeverisjen e sundimin e ligjit, dhe ku do të duhet të themi se kemi nevojë të bëjmë më shumë në interes të qytetarëve, në interes të ushtrimit sa më mirë të detyrave e të funksioneve tona parlamentare, por edhe në aspektin më të rëndësishëm, për të cilin vetë rezoluta dhe ky komision janë duke punuar për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian.

Thënë këtë, nëse duhet të bëj një përshkrim të të tre komponentëve, në vija të përgjithshme tre komponentët do të jenë:

-Komponenti i parë ka të bëjë me funksionet e Kuvendit, rolin mbikëqyrës e monitorues, e sigurisht funksionin ligjvënës.

-Komponenti i dytë ka të bëjë me të drejtat themelore të njeriut, mbrojtjen, respektimin dhe garantimin e tyre.

-Komponenti i tretë ka të bëjë me konsolidimin e reformës në drejtësi.

Në lidhje me komponentin e parë, për funksionet e Kuvendit, sa i takon funksionit ligjvënës, mendojmë se çdo komponent do të duhet të ketë disa çështje për të cilat do të duhet të kërkohet një analizë e thelluar. Pa i përmendur të gjitha, unë do të fokusohesha dy çështje: së pari te nevoja për një analizë e thellë, që të mund të dimë nga të gjitha raportet e nga të gjitha vlerësimet, të jashtme e të brendshme, që vetë Kuvendi ka në lidhje me gjetjet dhe problematikat në funksionin ligjvënës, në drejtim të cilësisë e të eficiencës së Kuvendit; gjithashtu, zbatimi i procesit të konsultimit publik nga Kuvendi, roli i komisioneve parlamentare, përfshirja e grupeve të interesit, platforma e konsultimit të projektligjeve. Këto janë mekanizma që i kemi, por kemi edhe raporte se si është kryer kjo punë, çfarë do të duhet të bëhet më mirë, sa përdoret kjo punë në të gjitha këto procese, për të cilat ky komision është thirrur të punojë e të japë rekomandime.

Sa i takon rolit mbikëqyrës, koordinues e monitorues të Kuvendit, duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, duhet të kemi në konsideratë faktin se në rolin mbikëqyrës të Kuvendit. Kjo natyrë e funksionit mbikëqyrës është e ndryshme, në varësi të institucioneve që raportojnë në Kuvend. Karakteristikat e këtij funksioni, jo vetëm në Shqipëri por në të gjitha vendet demokratike, janë të tilla që, duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, në disa raportime apo në disa monitorime kompetencat janë më të thella. Këto ndodhin kryesisht kur institucionet raportuese që lidhen drejtpërsëdrejti me kompetenca të organit ekzekutiv janë më të kufizuara dhe duhet të respektojnë disa karakteristika të sundimit të ligjit, kur bëhet fjalë për institucione të pavarura kushtetuese të krijuara me ligj apo institucione të pushteteve të tjera.

Thënë këtë, neve do të na duhet të kemi sot një analizë të kuadrit monitorues së Kuvendit, të procedurave e standardeve që përdorim në mbikëqyrjen parlamentare në lidhje me performancën e veprimtarisë së qeverisë dhe institucioneve të varësisë, të agjencive ekzekutive e institucioneve të pavarura, si dhe mbikëqyrjen periodike të zbatimit të rekomandimeve të tyre, përfshirë periodicitetin e seancave dëgjimore, vizitat në institucione dhe të gjitha format e tjera të parashikuara në mekanizmat që ka sot Kuvendi. Përveç parashikimeve kushtetuese e ligjore, ne kemi rregulla të detajuara në Rregulloren e Kuvendit, në vendimet e organeve të Kuvendit. Kemi gjithashtu raporte të organizatave ndërkombëtare, raporte të organizatave vendëse, por kemi edhe projekte asistence në Kuvend për të forcuar këtë rol.

Ajo që përbën bazën e të gjitha analizave ku kemi informacionin burimor për ta kryer këtë punë, por dhe të gjitha raportet e Bashkimit European në lidhje me këtë rol, është se do të na ndihmojnë të kuptojmë se si kryhen këto funksione, sa do të duhet të përmirësohen dhe ku do të duhet të përmirësohen, me çfarë metodologjie, në mënyrë që të përmbushen funksionet

përkatëse, siç e thashë, në respektim të parimit të ndarjes, balancimit të pushteteve, në favor të interesit publik e të procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Europian.

Mekanizmat për monitorimin e zbatimit të legjislacionit janë gjithashtu shumë të rëndësishme dhe përbëjnë atë që ne e quajmë kontroll postlegjislativ. Në fakt, ne i kemi të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit, por nuk kemi metodologji të detajuar, ndërkohë që gjithmonë e më shumë vjen në vëmendjen e Kuvendit nevoja për të kuptuar se sa efekt kanë ligjet, sa kanë ndikuar ligjet në jetën e qytetarëve, në përmirësimin e treguesve të mirëqeverisjes, apo çfarë ndryshimesh apo përmirësimesh do të duhet të bëhen në lidhje me këtë aspekt.

Neve na duhet një analizë e thellë edhe në lidhje me faktin se sa efektiv është dhe si funksionon koordinimi institucional, një tjetër rol që ka Kuvendi, jo vetëm në pjesën e parashikimeve të legjislacionit apo të akteve normative të vetë Kuvendit, por edhe në praktikë, dhe çfarë efektesh dhe rezultatesh ka sjellë ky rol. Në analizë vlerësojmë që është e nevojshme të vlerësohen dhe të kërkohen edhe gjetje për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe kushtetuese, si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që jepen për institucionet e administratës në përgjithësi, por ku Kuvendi ka një rol për nxitjen e zbatimit të tyre, sepse kanë të bëjnë me të drejtat themelore të shtetasve, si dhe të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e këtyre institucioneve të pavarura, nga të cilat unë përmenda vetëm dy, por janë disa, ndikojnë më së miri edhe në përmirësimin e rolit ligjvënës dhe në atë monitorues e koordinues të Kuvendit.

Po në analizën që duhet bërë për rolin e Kuvendit, një pjesë shumë të rëndësishme zënë edhe efektiviteti, transparencja dhe llogaridhënia e vetë Kuvendit. Ne e kemi diskutuar shpesh, ndërkohë besoj se të gjithë anëtarët e këtij komisioni tashmë i kanë të qarta raportet, edhe në sensin e rekomandimeve të dhëna në këtë aspekt, por Kuvendi ka një rol për të kuptuar se sa performanca e strukturave administrative, por edhe atyre politike, të Kuvendit, në shërbim të kompetencave të veta ligjvënëse, mbikëqyrëse, monitoruese dhe koordinuese të tij, është efektive në drejtim të pritshmërisë që vetë shteti ka, në kuadër të proceseve integruese të cilat jemi duke ndjekur dhe i kemi aspirata të rëndësishme. Për këtë arsye na duhen analiza për zbatimin e programeve dhe standardeve të transparencës së veprimtarisë së Kuvendit, në drejtim të aktorëve të shoqërisë civile, të palëve të tjera të interesuara dhe të publikut. Unë po përmend vetëm çështjet kyçe, sepse ka më shumë pika se kaq, por këto janë çështjet kryesore rreth të cilave ne mendojmë se ka nevojë për një analizë.

Mekanizmat ndërveprues të Kuvendit me aktorët e shoqërisë civile, median, publikun, jo vetëm për transparencën, në fakt, por edhe për llogaridhënien për veprimtarinë e organeve të Kuvendit dhe komisioneve parlamentare:

Pra, ne gjithmonë kemi mekanizma, kryejmë një proces të tillë, marrim mendime, përpiqemi t'i përfshijmë në të gjithë veprimtarinë tonë parlamentare, por shohim se, kur vjen puna tek analiza e punës sonë kur monitorohemi, bëjmë diskutime dhe nuk kemi një vijueshmëri për çfarë ndodh me gjetjet, me rekomandimet. Pra, kemi nevojë që këtë analizë ta kryejmë me masa konkrete, për t'u propozuar më pas në atë që konsiderohet si plan veprimi i përgjithshëm, i cili ndoshta do të jetë produkt i një faze të dytë të këtij komisioni.

Mekanizmat e transparencës për integritetin, *background*-in akademik profesional, deklarimin e pasurisë e të konfliktit të interesit të të zgjedhurve:

Edhe këtu kemi nevojë të bëjmë një analizë. Disa nga fushat për të cilat flasin nëngrupet e këtij komisioni lidhen me njëra-tjetrën, ndaj dhe ne koordinojmë nevojat që kemi për një analizë të thelluar së bashku.

Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e kësaj analize do të ishte edhe e gjithë veprimtaria e Kuvendit, pra një analizë tërësore e proceseve të zgjedhjes së drejtuesve të institucioneve të pavarura, duke përfshirë procesin meritokratik, transparent dhe dëgjuesat. Kjo kërkon një analizë dhe, thënë këtë, analiza duhet të bazohet përveç se në raportet që ne përmendëm, të cilat pak a shumë i kanë të gjitha grupet, janë ato që i kanë bërë një skaner Shqipërisë, si nga partnerët ndërkombëtarë, ashtu edhe nga organizatat vendase, edhe në këndvështrim me kuadrin ligjor që funksionon aktualisht në vendin tonë, sepse qëllimi do të jetë që nga kjo analizë të kemi disa gjetje, disa rezultate, për t'i adresuar si propozime në një plan veprimi që do të kërkojë më pas një punë tjetër, sipas 4 parimeve të punës së këtij komisioni, që zoti Xhafaj tha në fillim. Kjo i jep vlerë faktit që do të ketë një gjithëpërfshirje dhe ekspertizë. Në fakt, është një proces që, nëse i kushtohet vëmendje nga të gjithë, jo vetëm nga ne që jemi anëtarë komisioni këtu, është një proces, i cili, pak a shumë, është i të gjithë shoqërisë, pra duhet të ndihet si i tillë. Në këtë aspekt, mendoj se deri në këtë pikë, këto janë çështjet më të rëndësishme që do të doja të theksoja.

Ndërsa, për të kaluar te komponenti i dytë, për mbrojtjen, respektimin dhe mekanizmat garantues të të drejtave themelore të njeriut, do t'ia lë fjalën zotit Gogu. Unë do të shkoj më pas te komponenti i tretë.

Zoti Gogu.

Toni Gogu – Faleminderit, zonja Bushka!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar kolegë të komisionit të nderuar,

Përfaqësues të administratës së Kuvendit, të përfshirë në këtë proces,

Të nderuar përfaqësues të medias që ndiqni punimet e komisionit,

Brenda shtyllës së sundimit të ligjit, unë do të doja që në mënyrë të përmbledhur të flisja për analizën, komponentin e të drejtave të njeriut. Natyrisht, nuk jam duke thënë ndonjë gjë të re, kur përshkruaj se rruga në forcimin, mbrojtjen dhe sigurimin e një mekanizmi mbrojtës të të drejtave të njeriut, nuk është as e shpejtë, nuk është as e lehtë, por është e domosdoshme për të siguruar sundimin e ligjit.

Në të gjithë përshkrimin e punës së këtij komisioni deri tani mbizotëron një element, është elementi se si në luftën kundër korrupsionit dhe në synimin e një qeverisjeje më të mirë dhe të një shoqërie ku sundon ligji, ne dëshirojmë, kemi marrë në konsideratë dhe duam që të nënshtrojmë të gjithë atë revolucion teknologjik, i cili është aty dhe ndodh teksa ne flasim dhe që e ka ndryshuar këtë botë, e shohim se si e ka sjellë në këtë fazë, por edhe shoqërinë tonë, në shërbim të qytetarëve.

Ndërsa nga njëra anë forcohet teknologjia e informacionit, siç u përshkrua qoftë në komponentin e antikorrupsionit, por qoftë edhe në komponentin e mirëqeverisjes, kjo menjëherë shkon në baraspeshimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sepse i dimë fare mirë kërcënimet e këtij shekulli, pra teknologjia, ndër të tjera, kërcënon të drejtat e njeriut, qoftë përmes mbikëqyrjes teknologjike që mund të ndodhë, qoftë edhe përmes inteligjencës artificiale, që mund t'i përpunojë këto sondazhet dhe pritjet e publikut, siç po i shohim, qoftë përmes bioteknologjisë ose deri në ato rastet fatkeqe të diktaturave digjitale. Ndaj është jashtëzakonisht i rëndësishëm ky komponent. Së bashku me revolucionin teknologjik është shumë e rëndësishme që ne në mekanizmin mbrojtës të të drejtave të njeriut të marrim në konsideratë edhe kërcënime, siç janë qoftë pabarazia ekonomike, qoftë krimi kibertenik apo dezinformimi për të cilin ky Kuvend ka ngritur një komision të posaçëm.

Pa humbur kohë po kaloj në adresimin e kërcënimit kryesor që u vjen të drejtave të njeriut në shekullin që ne jetojmë dhe në këtë moment në shoqërinë tonë të pabarazisë ekonomike, garantimi i të drejtës së pronësisë do të jetë një nga elementet kryesore të punës së këtij komisioni. Ky komision do të analizojë gjetjet e procesit të zbatimit të së drejtës së pronësisë, duke përfshirë proceset kalimtare, kompensimin e pronës, shpronësimin e drejtë, natyrisht e gjitha kjo duke vendosur vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për çështjet e Shqipërisë si një udhërrëfyes bashkë me elementet e tjera që u përmendën, që janë dokumentet tona bazë.

Nga ana tjetër, rishikimi dhe marrja në konsideratë të thelluar të situatës aktuale, lidhur me funksionimin qoftë strukturor institucional apo qoftë edhe të procedurave të brendshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, bazuar, siç e thashë, në përdorimin e teknologjisë së informacionit është shumë e rëndësishme që e drejta e pronësisë t'i shërbejë kësaj gjëje, t'i shërbejë garantimit të të drejtës së pronësisë, duke synuar ndjeshëm ritmin e regjistrimit, pra regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Së fundmi do të shikojmë edhe zbatimin e ligjit për finalizimin e procesit kalimtar të pronësisë, pra, ndryshimet ligjore që janë bërë në këtë mandat qeverisës.

Garantimi i të drejtave të grupeve vulnerabël është një nënkomponent tjetër, këtu kam parasysh, qoftë për fëmijët, qoftë për të huajt, ndryshimet dhe përmirësimet në legjislacion, por edhe rritjen e kapaciteteve në legjislacionet përkatëse të fëmijëve dh të huajve, si dhe rritjen e kapaciteteve te punonjësit social, por edhe ato struktura që punojnë me të huajt, që janë jashtëzakonisht të rëndësishme për analizën dhe punën e këtij komisioni.

Pastaj do të shkojmë, tek ajo që përmenda, te kërcënimi nga krimi kibernetik që është tashmë realitet. Ne e kemi përjetuar, e dimë se si është dhe është debatuar shumë politikisht. Pavarësisht se këto takime me debate politike në fund të ditës nuk sjellin mirëqeverisjen, por janë takime, ndoshta të mërzitshme, që krijojnë punë, siç po ndodh në këto momente. Pra, janë takime ku ka punë kritike, ku nuk dorëzohet njeri; ku ka një mal me *email*-e; ku ka një mal komunikimesh; ku ka një mal dokumentesh të cilat diskutohen. Ndaj analizimi i funksionimit dhe i efikasitetit në rolin vendimmarrës të autoritetit për të drejtën e mbrojtjes, pra Komisionerit, për ne është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Por, zbatimin ose përafrimin plotësisht të direktivës së Bashkimit European për Mbrojtjen e të Dhënave, me sa di unë, Komisioneri tashmë e ka kryer si punë dhe na takon ne që ta marrim në konsideratë dhe ta analizojmë, është një nga elementet bazë të mbrojtjes së të drejtës për informacionin dhe të dhënat personale.

Përmirësimi ligjor, siç e thashë, në ligjin e krimit kibernetik është shumë i rëndësishëm, gjithashtu. Ndaj analiza në këtë fushë është e rëndësishme.

Te procesi i rregullt ligjor, në punën e komisionit, dua të theksoj që ne do të merremi me atë pjesë që është para dhe pas procesit, këtu kam parasysh që do të shqyrtojmë zbatimin e vendimeve gjyqësore, pra sa shpejt zhvillohen, çfarë pengesash ka dhe çfarë vështirësish ka në zbatimin e vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm.

Analiza për funksionimin dhe profesionalizmin e përfaqësuesve të shtetit dhe të institucioneve publike në proceset gjyqësore është jashtëzakonisht e rëndësishme. Pra, si mbrohen institucionet shtetërore, që në fund të ditës janë asemi më i madh i qytetarëve të këtij

vendi, të cilat garantojnë sundimin e ligjit në proceset gjyqësore, do të jetë një pjesë e punës shumë e rëndësishme e këtij komisioni, natyrisht duke iu përmbajtur standardeve dhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Për shkak se jemi duke folur për procesin e rregullt ligjor, i cili fillon që në momentin që qytetari ndeshet me punonjësit e policisë, për ne akademia e sigurimit dhe trajnimi i vazhdueshëm për kandidatët, për sa i përket procesit të rregullt ligjor, është i një rëndësie kyçe.

Te forcimi i institucioneve të pavarura kemi bërë një ndarje, sepse kemi dy lloj institucionesh. Kemi institucione të pavarura që ndikojnë drejtpërdrejtë në mbrojtjen e të drejtave themelore, siç janë: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi apo Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Por, nga ana tjetër, kemi edhe institucione ligjzbatuese, siç janë ato që raportuan dje në Kuvend, një pjesë e madhe e tyre. Tani po flas për forcimin e institucioneve që garantojnë të drejtat themelore të njeriut, ku do të analizojmë funksionimin dhe nevojat kushtetuese të këtyre institucioneve, edhe kur janë të krijuara me ligj të posaçëm, dhe zbatimin e vendimeve të tyre. Pra, vendimet e Avokatit të Popullit. Ne kemi parë në të gjitha raportimet e tyre që vendimet e tyre nuk zbatohen. Ndaj është shumë e rëndësishme të kuptojmë nëse kjo ka të bëjë me kulturën ligjore institucionale apo ka elemente të tjera. Kështu që, ky do të jetë një element i punës sonë, si dhe rishikimi i mekanizmave mbështetës për organizatat e shoqërisë civile ,që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe, siç e thashë më parë, të drejtat e grupeve vulnerabël.

E njëjta metodologji është për forcimin e institucioneve, të cilat, në njëfarë mënyre, mbikëqyrin tregje, ku qytetarët tanë ballafaqohen çdo ditë, këtu kam parasysh: Autoritetin e Konkurrencës, Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit ku, nga njëra anë, janë kornizat e tyre ligjore dhe, nga ana tjetër, rritja e kapaciteteve të tyre, për shkak se disa nga ato janë institucione me nevoja për rritje kapacitetesh.

Në fund, por jo i fundit për nga rëndësia, një element shumë i rëndësishëm apo nënkomponent i këtij komponenti është edukimi ligjor, dhe i kemi kushtuar një rëndësi shumë të veçantë edukimit ligjor. Do të doja të kishim një vlerësim kombëtar të nevojave për edukim ligjor të publikut, duke përfshirë grupmosha të ndryshme. Duhet të kemi parasysh që janë 690 mijë pensionistë, të cilët, nga njëra anë, duhet të përdorin teknologjinë e informacionit në aksesin që kanë në shërbimet shtetërore dhe, nga ana tjetër, duam të kuptojmë se si mund t'u përmbushen këtyre këto nevojat. E mora thjesht si grupmoshë.

Ndërkohë, mekanizmat ekzistues për përfshirjen e edukimit ligjor në çdo nivel të arsimit parauniversitar dhe universitar do të jetë element kyç i punës sonë. E kam

jashtëzakonisht përzemër, sidomos parashkollorin, pasi besoj se është një nga elementet ku formohet qytetari, sepse aty mëson sundimin e ligjit dhe mirëqeverisjen.

Rishikimi i gjithë asaj pune të madhe që është bërë sa u takon zyrave të shërbimit juridik falas, është një element shumë i rëndësishëm i edukimit ligjor, si dhe mundësitë e reja për qytetarët, që të kenë akses në shërbimet qeveritare, *helpdesk*-ët dhe banakët virtualë të shërbimit, të cilët duhet të jenë tërësisht miqësorë me qytetarët, pavarësisht edukimit të tij, moshës apo barrierave të tjera që mund të ketë.

Siç e thashë edhe në fillim, mund të dukemi të mërzitshëm me këto takime, por, të nderuar kolegë, reforma në drejtësi na ka mësuar që një politikë qeverisëse, që të ketë sukses ne nuk duhet të dorëzohemi apo të mos jepemi në takime të tilla. Nuk janë debatet televizive, nuk janë mitingjet dhe takimet me simpatizantët politik ato që bëjnë që një politikë në shërbim të qytetarëve të zbatohet, por janë takimet, puna dhe vetëm puna që prodhojnë dokumentacion.

Ju falënderoj edhe një herë për vëmendjen, zonja Bushka ka edhe nënkomponentin e fundit.

Fatmir Xhafaj – Zoti Shalsi e kërkon fjalën për një ndërhyrje, meqenëse ka një angazhim tjetër.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam pjesë, bashkë me Milvën dhe me Evisin, e komponentit të mirëqeverisjes, po doja të vendosja theksin te diçka që përmendi Klotilda, që ka lidhje me rolin e Kuvendit, që është i pazëvendësueshëm, i domosdoshëm dhe që, në mënyrë që t'u përgjigjet sfidave që shtron përpara procesi i integritetit, por edhe thellimi i reformave, duhet të kalojë në një *new level palying field*, siç thonë anglezët, në një nivel të ri. Që Kuvendi t'u përgjigjet këtyre sfidave është e domosdoshme që edhe shërbimet mbështetëse, teknologjia e informacionit, të jenë në lartësinë e duhur. Me këtë ndërhyrje unë thjesht dhe vetëm doja që ashtu sikundër ne jemi të vetëdijshëm për rolin, ta theksoja, ta ritheksoja edhe një herë, që nuk do të mund t'u përgjigjemi këtyre sfidave nëse nuk do të japim me shembullin tonë edhe një proces përmirësimi brenda vetes sonë, brenda Kuvendit. Ndaj, do të doja të vendosja theksin tek ai proces që ne kemi nisur, dhe besoj do të informohemi në ditët në vijim se në ç'fazë është procesi i reformimit, i ristrukturimit, fuqizimit të rolit të mbështetjes nga brenda Kuvendit. Në këtë moment sfidash të jashtëzakonshme do të duhet të provojmë që kapacitetet, burimet njerëzore, struktura e Parlamentit, logjistika mbështetëse, bëjnë të mundur që roli ynë të jetë ai që përcakton Kushtetuta dhe ai që presin njerëzit.

Këtë ndërhyrje doja të bëja vetëm, duke kërkuar edhe mirëkuptimin e kolegeve dhe koleges.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Shalsi!

Mbetemi përsëri te sundimi i ligjit.

Zonja Bushka.

Klotilda Bushka - Faleminderit, kryetar!

Atëherë, komponenti i tretë i shtyllës “Sundimi i ligjit” është konsolidimi i reformës në drejtësi. Më fakt, në bazë të reformës, Shqipëria po krijon një sistem drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili duhet të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillim e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen europiane. Ky mbetet qëllimi që drejton, në fakt, konsolidimin e reformës në drejtësi një proces, i cili është duke u zbatuar hap pas hapi edhe me mbështetjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Ndaj, ne e shohim si një komponent shumë të rëndësishëm të shtyllës “Sundimi i ligjit” këtë çështje, në bazë të së cilës ne mendojmë që një analizë do të na shërbente për të kuptuar arritjet, sfidat që vërehen në zbatimin e reformës në drejtësi, mbështetur në vlerësimet, gjetjet, problematikat dhe rekomandimet e dhëna në këtë fushë nga progresraportet e BE-së, raporti *Screening, cluster I* i Komisionit Europian, *Rule of Law Report*, apo Raporti i Sundimit të Ligjit i vitit 2024, kapitulli për Shqipërinë. Kemi masat kyçe të udhërrëfyesit të miratuar për shtetin e së drejtës, reformën e administratës publike, udhërrëfyesin e funksionimit të institucioneve demokratike, që kanë gjetje, vlerësime dhe rekomandime në këtë aspekt dhe raportet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës në kuadër të monitorimit të Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve si vend anëtar i Këshillit të Europës.

Duke qenë se kjo është një çështje e rëndësishme, me mbështetjen e stafit të Kuvendit, në fakt, që është pjesë e sekretariatit teknik të këtij komisioni, është përgatitur një draftkoncept fillestar, i cili do të duhet të konsultohet paraprakisht, para se të bëhet publik dhe të kthehet në një dokument pune, me grupin e ekspertëve të reformës, me nëngrupin e përfaqësuesve dhe ekspertëve të vetë institucioneve të drejtësisë, të cilët janë ftuar të jenë pjesë e këtij komisioni, dhe do të duhet që kjo lloj analize të bëhet me ta, prej tyre, për pjesën që lidhet me funksionet përkatëse, me qëllim që të propozohen masat që duhen, që vlerësohen të ndërmerren, që mund të jenë pjesë e planit kombëtar të veprimit sipas fushave të përgjegjësisë. Pjesë shumë e rëndësishme e këtij procesi do të duhet të jetë dhe konsultimi me misionet e asistencës ndërkombëtare që monitorojnë, asistojnë dhe mbështesin sistemin tonë të drejtësisë, mbështetur edhe në marrëveshjet përkatëse me shtetin shqiptar.

Në një vështrim të përgjithshëm, çështjet kryesore, nisur nga rekomandimet e dhëna nga raporti i ndërkombëtarëve, por jo vetëm, edhe nga vlerësimet e organizatave të shoqërisë civile vendase, raportet që kanë ardhur dhe në Kuvend, në kuadër të veprimtarive vjetore apo çështjeve që ngrihen nga vetë institucionet e drejtësisë, mendojmë që fushat e punës për një analizë më të thellë do të duhet të ndahen në disa çështje, në mënyrë të përgjithshme: pavarësia dhe paanësia e sistemit të drejtësisë, llogaridhënia, cilësia e drejtësisë, eficienta e drejtësisë dhe aksesit në shërbimet e sistemit të drejtësisë, mirëqeverisja dhe transparencja. Këto çështje janë pjesë edhe e kuadrit të përgjithshëm të punës së komisionit për sa i takon mirëqeverisjes. Mirëqeverisja nuk duhet të kuptohet vetëm si çështje e një dege të shtetit, por e të gjithë shtetit në tërësi, aq më tepër në kuadër të procesit integruar në Bashkimin Europian, ku detyrimet janë për shtetin shqiptar dhe të gjithë duhet t'u përgjigjen këtyre nevojave në interes të publikut.

Thënë këtë, këto janë propozimet tona për një strukturë analize, që ne gjykojmë se do të duhet të jetë në fokus të punës së të gjithë atyre që do të punojnë për të çuar përpara këtë punë, sipas metodologjisë që ju tashmë, kryetar, e keni prezantuar disa herë dhe ne kemi miratuar disa vendime.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Besoj se biem dakord dhe me këtë qasje të fundit, që u propozua lidhur me komponentin që ka të bëjë me konsolidimin e reformës në drejtësi. Mendoj që parashtesa e zonjës Bushka ishte shumë e qartë. Është e vërtetë që është përgatitur një konceptide për këtë gjë, lidhur me strukturën e mundshme mbi ato shtylla që u parashtruan këtu, por është e domosdoshme t'i qëndrojmë metodologjisë që kemi përcaktuar. Ne këtu e kemi përcaktuar, e kemi dakordësuar, e kemi hedhur dhe në dokumente, në rezolutë, edhe në vendim, që ky do të jetë një proces i bërë së bashku me aktorët e sistemit të drejtësisë. Pra, janë ata, të cilët, përmes përfaqësuesve, ekspertëve dhe profesionistëve të tyre, do ta ndërtojmë këtë proces nën koordinimin dhe drejtimin tonë, natyrisht dhe ata në një proces ekspertize gjithëpërfshirëse, transparente dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, të asistuar nga asistencja ndërkombëtare, siç e parashtroi zonja Bushka, sepse ka dhe një arsye dhe një diferencë me reformën në drejtësi.

Në reformën në drejtësi organet e sistemit ishin objekt i punës së reformës, sot institucionet e sistemit janë partnere në këtë reformë dhe ato duhet të trajtohen, të vlerësohen dhe të respektohen si të tilla. Janë ato, si partneret e këtij pushteti, pra, ai pushtet, në bashkëpunim dhe duke respektuar parimin e madh të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, që do të ulen në një tryezë pune të tyre, do të bëjnë analizën e punës së tyre, do të nxjerrin problematikat, bazuar dhe në ato problematika, gjetje dhe ato propozime, që tashmë ata i kanë

bërë prezent në Komisionin e Ligjeve përmes raporteve të tyre dhe që janë shprehur nga rezolutat që komisioni i ka çuar Kuvendit. Kështu që, besoj se është një gjetje dhe një zgjidhje e arsyeshme, duke bërë këtë diferencë nga puna e përgjithshme, nga këndvështrimi i përgjithshëm i këtij dokumenti analitik.

Ka dikush diçka tjetër për të shtuar? Kemi ndonjë gjë? Dakord.

Së pari, në përmbyllje, dua t'u shpreh falënderimet të gjithë kolegëve për angazhimin shumë serioz dhe për këtë punë cilësore që është bërë me këtë dokument, në këndvështrimin tim, me këtë projektide, që ka të bëjë me strukturën e dokumentit analitik, e cila ka edhe një vlerë tjetër, shumë të rëndësishme, që tregon qasjen, vizionin dhe qëndrimin tonë për këto çështje, njëkohësisht, është një shprehje e reflektimit tonë mbi problematikat që kemi në këto fusha; është një shprehje e përgjegjësisë sonë për t'i njohur dhe për të reflektuar mbi këto problematika, qoftë edhe mbi gabimet që mund të jenë bërë në proces, qoftë në fushën e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit, dhe kryesoja për t'i konsoliduar arritjet dhe sukseset në të gjithë këtë periudhë të gjatë, e cila tashmë është e domosdoshme, edhe në vazhdim të reformës së sistemit të drejtësisë, për t'u përfshirë dhe për t'u fokusuar më shumë edhe në këta komponentë të tjerë.

Gjithsesi, ky është një dokument i hapur, radhën e punës tashmë e ka sekretariati teknik, i cili duhet ta përgatisë të gjithë dokumentin, si një tekst të integruar, për ta vënë në dispozicion, duke i marrë të gjitha pjesët e kolegëve për ta ndërtuar si dokument të integruar, që më pas t'u paraqitet ekspertëve, për të pasur orientimin e punës dhe për të filluar hartimin e këtij dokumenti tejet të rëndësishëm.

Së dyti, sekretari teknik duhet të përgatisë mbledhjen për miratimin e grupit të ekspertëve dhe përbërjen finale të sekretariatit mbi bazën e propozimeve të sjella nga shoqëria civile, nga bota akademike, nga radhët e pedagogëve, nga komuniteti i biznesit, nga grupet e interesit, por edhe nga organizatat ndërkombëtare apo konsulentët ndërkombëtarë, që kanë shprehur apo janë në procesin e shprehjes së interesit për të asistuar apo për të kontribuar në formën e konsulencës apo të asistencës së këtij procesi.

Së treti, javën e ardhshme duhet të bëjmë takimin me grupet e ekspertëve, në mënyrë që t'i koordinojmë ata në të gjithë këtë proces dhe për t'ju kaluar atyre stafetën, sipas metodologjisë së përcaktuar, përgjegjësinë e të gjithë këtij procesi.

Në mbyllje, edhe një herë, dëshiroj që të falënderoj kolegët për punën e jashtëzakonshme, me shumë përgjegjshmëri dhe me shumë përkushtim, në një kohë kaq të shkurtër, sepse janë dashur faqe e faqe dhe dokumente të pafundme për t'u studiuar dhe për të reflektuar mbi to, për të ardhur në këtë produkt dhe, krahas shumë angazhimeve të tjera që kanë

kolegët, si drejtues komisionesh apo si deputetë me angazhimet në zonat e tyre elektorale, i kanë lënë kohë dhe mundësi një angazhimi aktiv në këtë çështje, për të sjellë këtë produkt kaq cilësor, në vlerësimin tim.

Së dyti, dua t'i shpreh edhe një herë falënderimet Institutit Parlamentar për studimin e përgatitur, zotit Gjevori dhe ekipit të tij; në mënyrë të veçantë, dua të falënderoj tri zonjat e stafit të Kuvendit, koordinatorë të nëngrupeve të sekretarit teknik: zonjën Vladi, zonjën Dida dhe zonjën Zenelaj për punën, të cilat, krahas angazhimeve të tjera që kanë në Kuvend, ashtu siç kanë angazhime në 2-3 fusha, kanë edhe këtë angazhim, të cilat e kanë bërë këtë punë me shumë përgjegjshmëri dhe me shumë përkushtim, dhe unë shpresoj se do të vazhdojnë me njëjtin ritëm.

Gjithashtu, dua të falënderoj për kontributin Flavian, Elvin, Ilirin dhe zonjën Luzi, e cila i është bashkuar ekipit të sekretarit teknik.

Një falënderim të veçantë dua t'u bëj edhe dy ministereve të Shtetit: zonjës Dhuka dhe zonjës Pirdeni, gjithashtu edhe stafeve të tyre për disponibilitetin, për mbështetjen me të dhëna dhe me dokumente voluminoze, por edhe me ekstrakte të ndryshme, që kanë vënë në dispozicionin tonë për të arritur në dokument final.

Këtu e mbyllim mbledhjen e sotme.

Faleminderit!

Mbledhja e ardhshme, ashtu siç ju thashë, kryesisht do të jetë e fokusuar te miratimi i grupeve të ekspertëve dhe sekretariatit teknik.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit
Elvi Prifti